

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	250-25-2783-5-2-1
------------------	-------------------

Sa i përket tenderit për **Renovimi i Oborrit dhe Hapësirave të mbrendshme në objektin e Prokurorisë Themelore në Prizren**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**SMART ENG GROUP SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rruga Brigada 123, p.n.**

(Adresa)

**Suharekë**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+38349220599**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Astrit Tahiri**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**eng.smart2021@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**09.06.2025**

(Data e parashtrimit të kërkesës)

SH.P.K.  
SMART ENG GROUP  
N.U.I 811496014

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë – 04.04.2025
- Hapja e ofertave – 25.04.2025
- Njoftimi mbi vendimin – 19.05.2025
- Kërkesa për ri shqyrtim – 23.05.2025
- Vendimi i AK-se – Refuzimi – 28.05.2025

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

- Hapja e ofertave – 25.04.2025

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues "Smart Eng Group" shpk, me datën 23.05.2025, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim te vendmint – propozimit për dhënie te kontratës ne AK – KPK, ku ka paraqit prova dhe dëshmi për shkelje te shumefishta ligjore por pavaresisht kesaje AK – KPK, zyra e prokurimit ka vazhduar tutje dhe ka lene ne fuqi vendmin e saje kundër ligjore, ndërsa kerkesen tone për ri shqyrtim e ka refuzuar si te pa baze !

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

### Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar:

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrevshjeve,

### Rregullorja me nr 001/2022, për Prokurim Publik:

- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 97 Shkeljet e rënda

### Ligjit nr. 06/L081, për Qasje ne Dokumente Publike:

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Te nderuar,

Operatori ekonomik ankues, lideri i grupit "Smart Eng Group" shpk, me datën 23.05.2025, ka

parashtruar kerkese për ri shqyrtim tek Autoriteti Kontraktues – Këshilli Prokurorial i Kosovës – zyra e Prokurimit për këtë procedure te prokurimit, ku janë paraqitur prova reale për veprime kundërligjore dhe AK, me vendimin e sajë te datës 28.05.2025, ka refuzuar kerkesen tone si te pa baze dhe ka lejuar te procedohet tutje pavaresisht faktit se është propozuar për dhenien e kontratës kompani e pa pergjegjeshme.

- **Prove:** Vendmi i datës 28.05.2025

Prandaj, operatori ekonomik ankues, lideri i grupit “Smart Eng Group” shpk, bazuar ne nenin 109, te LPP-se dhe afatin ligjore paraqet argumentet si me poshte:

### **Pretendimi ankimore 1.**

Ne vendimin e AK- KPK, për refuzim te kerkeses për ri shqyrtim te pershkruar si me sipër, zyrtari pergjegjës i prokurimit ka konsumuar shkelje esenciale nga nenin 108/Atë LPP-se, përkatësisht asnjërin nga pretendimet tona ankimore nuk e trajton dhe nuk e prezanton bazen ligjore ashtu siç percaktohet me LPP dhe deformon gjendjen faktike.

Si fillim ne si OE kerkesen për ri shqyrtim e kemi paraqitur me datën 23.05.2025, perderisa vendmi i AK-se është nxjerre me datën 28.05.2025, apo ditën e 5, perderisa me paragrafin 6 te te njejtut nen percaktohet qe: AK do ta shqyrtoj kerkesen brenda tre (3) dite nga data e dorezimit te kerkeses, si rrjedhoje AK – KPK, zyra e prokurimit ka konsumuar gjithesej 4 dite pune dhe nuk ka nxjerre vendmim për zgjatje te afatit, si rrjedhoje e kesaje nuk është trajtuar asnjëri nga pretendimet tona anakimore.

Ne emer te pergjigjes ndaj pretendimeve tona ankimore AK e mohon gjendjen faktike te ofertës se OE te propozuar për dhenin e kontratës dhe e fshehe pa pergjegjeshmerin e tij dhe pershkruan dispozitat ligjore dhe tenton ti zberthen ato se cili është qellimi i nenin 52, 56 etj, madje ne vendmim pershkruhet se dispozitat ligjore kane qellim për udhezim te AK-se se si duhet te specifikojne kriteret !!!

Dispozitat ligjore te LPP-se dhe jo vetëm janë obligative për tu zbatuar nga AK-te perkates dhe palet e tjera te prfshira ne procedura te prokurimit. Për tu udhezuar është Udhezuesi për prokurim publik madje ende ne fuqi, ligji është për tu zbatuar dhe obligimi ligjore është qe pretendimet ankimore te trajtohen vec e vec, ky fakt percaktohet me nenin 108/A, te LPP-se, paragrafi 8, pika 8.4, ku percaktohet:

**8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:**

**8.4 autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.**

### **Pretendimi ankimore 2.**

Pas publikimit te vendimit mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit, ne si operator ekonomik, pjesemarres ne këtë procedure te prokurimit, dhe pale me interes juridik siç percaktohet me nenin 4.1.26, te LPP-se, kemi kerkuar qasje ne dokumente – ofertën e teresishme te operatorit ekonomik te propozuar për dhënie te kontratës, si rrjedhoje me datën 21.05.2025, jemi paraqitur ne zyren e prokurimit dhe nuk na është ofruar qasje ashtu siç percaktohet me dispozita ligjore, perderisa ne procesverbal është pershkruar qellisht se është ofruar qasje e

pa kufizuar, por neve si OE, nuk na është ofruar kurrefare dokuemnti as ne forme fizike dhe as elektronike dhe me këtë veprim është shkel paragrafi 3 dhe 5 i nenit 10 te LPP-se.

Pas kesaje lideri i grupir, te nesermen me datën 22.05.2025, kemi ri parashtruar kerkese dhe kemi kerkuar dokumentacionin e OE te propozuar për dhenien e kontratës dhe AK, perseri ka mohuar dhe nuk ka ofruar qasje ne prova dhe dëshmi dokumentare te ofertës se OE, te propozuar për dhenjein e kontratës dhe krejt kjo me qellim te caktuar për te favorizuar te njejten kompani për lidhje te kontratës kundërligjore, me te cilen mund te shkaktohet pasoje financiare dhe ligjore.

**Prove:** Kerkesa e datës 21.05.2025 dhe ri kerkesa e datës 22.05.2025.

Autoriteti Kontraktues –KPK – Zyra e Prokurimit, përkundër kerkeses për qasje përkundër bazes ligjore ka mohuar ofrimin e qasjes dhe me këtë tentohet te vazhdohet tutje me oferte te pa pergjegjeshme dhe te lidhet kontrate kundërligjore me kompani te pa pergjegjeshme.

Ky fakt tregohet me vet faktin e mohimit te ofrimit te qasjes se pa kufizuar përkatësisht ne formen siç e përcakton ligji për prokurim publik dhe jo vetëm. Madje ne si OE nuk kemi pranuar as aneksin perkates ku operatori ekonomik i propozuar për dhënie te kontratës e ka deklaruar ofertën e tij si konfidenciale dhe nuk kemi te dhena për këtë.

Krejt kjo konfirmohet me vendmin e datës 28.05.2025, për refuzim te kerkeses për ri shqyrtim ku kjarte pershkruhet se ne kemi nenshku procesverbalin dhe kemi pranuar qasjen vetëm ne shiqim dhe jo ne forme fizike.

Mohimi i qasjes ne dokumentacion publik është shkelje esenciale e ligjit për prokurim publik, nr 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligje tjere.

Neni 10 dhe 11, i LPP-se, përkatësisht nenit 7, i rregullores për prokurim publik, trajton qeshtjen e qasjes dhe dokumentacionit afarist.

Neni 11, paragrafi 6 dhe 7 përcaktojnë:

*Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:*

*a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist".*

*b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.*

*Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik.*

Ne si kompani nuk jemi te njoftuar lidhur me konfidencialitetin e ofertës se OE te propozuar për dhenie te kontratës, prandaj juve si AK, keni mohuar qasjen ne dokumente te cilat janë te qaseshme nga palet e treta dhe aq me pak nga palet e perfshira direkt ne procedure.

Kompania jone është pale ne procedure dhe disponon interes juridik i përcaktuar me nenin 4.1.26 te LPP-se dhe e demtuar me rastine vlerësimit te ofertave.

Dispozita te nenit. 11, i LPP-se, paragrafi 3, pika 3.3 dhe 4, përcaktojnë qe: *“OE, i cili deklaron ofertën konfidenciale duhet te argumentoi përmes deklaratës me shkrim, ku domosdo duhet te vërtetohet se ndonjëri nga elementet e tenderit nuk është prone publike dhe te dhënat mbrohen dhe ne detaje do te arsyetohet konfidencialiteti apo sekreti ku zbulimi i tyre do te rezultonte me dëmtim material apo komercial te operatorit ekonomik”.*

Ne anen tjetër paragrafi 4 i nenit 11, te LPP-se përcakton se:

*“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste”.*

Kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, aspekti administrativ, paramasa dhe parallogaria, Certifikatat e biznesit, aspekti teknik dhe dokumentet tjera, siç janë kualifikimet e stafit, CV, nuk mund te klasifikon si sekret afarist.

Ligjërisht sekret afarist mund te konsiderohen vetëm te dhënat personale. AK -KPK, zyra e Prokurimit, ne kuptim te paragrafit 4 te nenit 11 te LPP-se, është dashur ta përgatise versionin e pastruar te dokumenteve ndaj OE-ve te cilët i kane deklaruar ofertat e tyre si te tilla. Rrjedhimisht me mos ofrim te qasjes, ju si AK - MSH, keni shkelur edhe dispozitat e nenit 10 te LPP-se - mjetet për promovimin e transparencës.

E drejta për qasje ne dokumente publike është e drejte bazike madje e garantuar me Kushtetute te Republikës se Kosovës, e qe sipas nenit 41 perkufizohet qe:

- Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.
- Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Neni 97 i Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, pika C), mos ofrimin e qasjes e klasifikon si shkelje te rende te ligjit për prokurim publik.

c) Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga

*pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.*

Qasja e plote ne dokumente publike është e garantuar edhe me nënparagrafin 3.2, te nenit 17 te ligjit nr. 06/L081, për Qasje ne Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, te ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e te dhënave personale.

OE ankues se bashku me këtë kerkese ne te njejten kohe do te paraqese ankese edhe ne organe tjera siç eshte agjencione perkatese për veprime kundërligjore, shkelje te parimeve dhe tentativ për keqpërdorim dhe abuzim te paras publike.

- Për këtë qeshje OSHP, ka nxjerr disa vendime ku mohimi i qasjes ne dokumente publike është gjykuar ndryshe nga AK.
- Ne ueb faqen e OSHP-se mund ti referoheni vendimit me nr. 606/23 ; 877/23 e shum vendime tjera.
- Për mos ofrim te qasjes ne dokumente publike edhe Agjencia për Informim dhe Privatesi ka te nxjerra me dhjetra vendime për mos ofrim te qasjes madje edhe shqiptim gjobash.
- Ne ueb faqen e AIP gjeni shum vendime mesin e tyre vendimet me nr. 770/2024; 875/2024 e shum te tejere.

#### **Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës, nga par 3 deri 5, percaktohet:**

- *Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatare sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.*
- *Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.*
- *Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.*

Ne si OE nuk kemi pranuar kurrefare shkrese dokumenti as ne formen fizike dhe as elektronike.

### **Pretendmi ankimore 3**

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ne FDT, juve si AK, ne pozicionin 4, keni kërkuar:

*Një Teknik ose Bachelor i Ndërtimit drejtimi Konstruktiv minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit*

- Deshmia

*Për Teknikë të paraqiten Diploma (kopje) nga origjinali, CV, dhe dëshmi mbi përvojën e punës*

Operatori Ekonomik të AK – KPK – zyra e prokurimit e ka rekomanduar për dhenien e kontratës, ne oferte nuk ka prezantuar kurrëfarë deshmie apo prove lidhur me këtë kërkesë kualifikuese. Pavaresisht mohimit të ofrimit të qasjes ne formen fizike apo elektronik ne ofertën e OE të propozuar kunderligjeshëm për kontratë, nuk kemi hasur ne prove apo dëshmi se është prantuar staf ne raport me këtë kërkesë.

Si rrjedhojë kjo kërkesë nuk mund të mbulohet me kërkesën e përcaktuar ne pozicionin 2, ku është kërkuar menaxheri i kontratës – inxhinieri i ndërtimit, pasi që këto kërkesa janë të ndara, si rrjedhojë propozimi për dhenien e kontratës me oferte të tilla konsumon shkelje ligjore të LPP-se si tërësi dhe ne veqanti nenit 59.3 të LPP-se, ku kjarë përcaktohet që: Autoriteti Kontraktues, do ta konsideroi një oferte të përgjegjshme vetëm atëherë kur plotësohen të gjitha kërkesat kualifikuese. Ne vendimin e nxjerre ndaj kërkesës sonë për ri shqyrtim AK, ndaj kësaj pretendimi ankimorë përshkruan emrin Dervishar me kualifikim – inxhinier i ndërtimit, por për drejtimin konstruktiv AK, ka aplikuar kërkesë tjetër tek stafi kyç dhe i njëti inxhinier nuk mund të plotësoi dy kërkesa kualifikuese dhe për këtë qeshtë AK – KPK, zyra e prokurimit haptazi ka favorizuar kompaninë e propozuar për dhenien e kontratës.

### **Pretendmi ankimore 4**

Ngjashëm është vepruar edhe me pjesën tjetër të stafit, ku OE i propozuar për dhenien e kontratës ka prezantuar kontrata marreveshje të bashkepunimit dhe dokumente tjera të cilat nuk përkojnë me gjendjen faktike, perkateisht kontrata dhe marreveshjet e bashkepunimit me një pjesë tjetër të stafit, sipas përshkrimit në kontrata – marreveshje të bashkepunimit nuk korespondojnë me gjendjen e deklarimit në ATK, po të verifikohet deklarimi i të punësuarit online.

Ne dokumente të prezantuara ne oferte është përcaktuar data e fillimit të punëve, orari i punës dhe qeshtet tjera, por që në realitet stafi i angazhuar dhe i prezantuar është pjesë e kompanive tjera dhe jo i OE të propozuar për dhenien e kontratës, prandaj komisioni vlerësues i ofertave nuk ka realizuar vlerësim, ekzaminim dhe krahasim të ofertave siç përcakton LPP. Për këtë qeshtë dhe këtë pretendim AK – KPK, nuk ka dhënë kurrëfarë përgjigje në vendimin e sajë të datës 28.05.2025.

Për këtë qeshtë në ueb faqen e ATK-se keni të publikuar sqarimin si më poshtë:

K publikon formën për lajmërimin e punëtorit

Administrata Tatimore e Kosovës ju njofton se sot me datë 13 shkurt 2024 publikoj Versionin e ri të Sistemit Elektronik EDI, përmes të cilit do të kërkohet që çdo punëdhënësi të informojë ATK-në për lidhjen e një kontrate të punës një ditë para fillimit të punës së punëtorit. Shërbimi i ri elektronik për lajmërimin e punëtorit është funksionalizuar në Sistemin Elektronik



EDI duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, gjegjësisht nënën 43, paragrafin 5.

Përmes këtij shërbimi, çdo punëdhënës është i obliguar për ofrimin e informatave për të punësuarin e ri, sipas formës së përcaktuar nga ATK-ja, e cila gjendet te menyja “Shërbimet – Regjistro punëtorin e ri”.

Më konkretisht përmes shërbimit “Formular për regjistrimin e punëtorit”, përveç informatave që merren përmes Agjencisë për Regjistrimin Civil (ARC) dhe informatave përmes listëpagesës mujore, punëdhënësi do të jetë i obliguar që të ofroj edhe informatat shtesë, si:

- Data e fillimit të punës;
- Data e ndërprerjes së punësimit;
- Orari i punës, i plotë apo i pjesshëm;
- Niveli i shkollimit të punëtorit;
- Profesioni i punëtorit;
- Pozita e punës së punëtorit, etj.

Për plotësimin e saktë të informatave për të punësuarin, ATK-ja ka përgatitur “Udhëzuesin për plotësimin e formularit për regjistrimin e punëtorëve”, të cilin do ta gjeni në dritaren përkatëse në të cilën bëhet plotësimi i formularit, andaj ju sugjerojmë që paraprakisht ta shfletoni udhëzuesin.

ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!

Administrata Tatimore e Kosovës

Çdo person nga muaji shkurt 2024 që ma dergoni ne list te pagave duhet te jet i deklaruar paraprakisht ne Atk nga ana juaj ,

### **Pretendimi ankimore 5**

Ne kerkesat tjera te kapacitetit teknik dhe profesional, gjegjesisht ne pozicionin për pajisjet teknike ku perveq tjerash është kerkuar edhe:

*“...Një korpe per pune ne largesi, ....Sharr per prerjen e asfaltit betonit”,*

- **Deshmia:**

*Lista e paisjeve -origjinale - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve të ofrohen dëshmit në kopje deshmi (kopjet e librezave fatura ose DuD-I etj ,që kompania I ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera.*

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhenien e kontratës ne oferte nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me këto kerkesa. Ne emer te Korpes për Pune ne largesi ne oferte ka prezantuar librezën e qarkullimit rrugore për pajisjen me pershkrim: **Kamion special**, si rrjedhoje kjo dëshmi nuk ka kurrefare lidhje me kerkesen kualifikuese, prandaj oferta e operatorit ekonomik te propozuar për dhenien e kontratës është ne tërësi e pa pergjegjeshme.

Ne vendimi e nxjerre ndaj kerkeses për ri shqyrtim zyrtaret pergjegjës te prokurimit ne AK, ne vend se te prezantojne fakte dhe prova për te njejten pajisje i referohen marreveshjeve te kompanis me kompani tjera dhe nuk prezantojne prov për kerkesen kualifikuese, madje haptazi manipulohet gjendja faktike dhe “shpjegohet” qellimi i dispozitave ligjore !!!

Ngjashem është vepruar edhe me pajisjen tjetër “Sharr për prerjen e asfaltit” OE ne oferte nuk ka prezantuar kurrefare deshmi lidhur me këtë pajisje teknike dhe si e tille oferta ka qene

dashur te eliminohet si e pa pergjegjeshme dhe jo te shperblehet me kontrate ku AK edhe ndaj keti pretendmi ankimore nuk prezantoh kurrefar fakti lidhur me pletesimin e kesaje kerkese.

Fakti i quditeshem dhe paradoksi qendron kur ne vendim pershkruset se "AK, me vemendje i ka analizu te gjitha pretendimet e OE ankues". Ne si kompani jemi te bindur qe per kete procedure te prokurimit OE i propozuar eshte i pa pergjegjeshem dhe se AK, me cdo kusht kerkon te lidhe kontrate me te njejten kompani te pa pergjegjeshme.

Rekomandimi i tille bien ndesh me nenin 59, par 4, ku kjarre percaktohet qe:

*"Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit..."*

#### **Pretendmi ankimore 6**

Ne piken 5.1 te FDT-se, eshte percaktuar afatin per fillimin / ose perfundimin e kontratës dhe ate keni percaktuar se kontrata duhet te realizohet **per tre (3) muaj**.

Kushtet dhe kërkesat dërgesës	5.1	Vendi i ekzekutimit te punëve është: <i>Në objektin e Prokurorisë Themelore në Prizren</i>
	5.2	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës:  në muaj 3

Operatori Ekonomik i propozuar për dhenien e kontratës ne oferte nuk ka prezantuar kurrefare deklarate apo plan dinamik për realizimin e puneve pavaresisht kerkeses se percaktuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate, si rrjedhoje edhe ky fakt mohohet nga zyra e prokurimit dhe ne vendmimin e saje te datës 28.05.2025, potencohet se një gje e tille nuk është kerkuar.

Kto veprime tregojne për shkelje te parimeve te prokurimit publik, tregojne për mos vlerësim mos ekzaminim dhe mos krahasim te ofertave ne raport me kerkesat kualifikuese te vete percaktuara ne dosjen e tenderit.

Te gjitha faktet e sipër prezantuara, tregojne për favorizim, për vlerësim te njeaneshme dhe pa i perfillur kerkesat e percaktuara ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate, prandaj ne si operator ekonomik, përkatësisht lideri i grupit, përmes kesaje ankese kerkon nga zyrtaret përgjegjës te OSHIP-se, qe te autorizoin ekspert shqyrtues, me integritet, te pa aneshem dhe i cili bazuar ne dispozitat e nenit 113 dhe 114 i trajton te gjitha pretendmimet ankimore ne atë mënyrë qe Paneli Shqyrtues te nxjerrni këtë:

**VENDIM**

- **Aprovohet** ne tërësi, si e bazuar ankesa e OE “ Smart Eng Group” shpk
- **Anulohet**, njoftimi i datës 15.05.2025, formulari B58, propozimi për dhenin e kontratës si i kunderligjeshem dhe lënda kthehet ne **Ri-vlereim**.
- **Lejohet**, kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Ne si OE, përmes perfaqesuesit te autorizuar liderin e grupit detyrimisht ne rast te mos ndermarrjes se veprimeve ligjore dhe mos prezantimit te gjendjes faktike, këtë lende do ta deponojme edhe ne Prokurin e Shtetit mqe eksistojne prova te cilat tejkalojne dyshimin e bazuar mire për keqperdorim te pozites, përkatësisht keqperdorimit dhe mashtrimit ne prokurim publik.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Te konsideruara, por deri me tani te pa kalkuluar,

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

